

## **SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE**

**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020**

**(Të gjitha balancat janë në lekë).**

### **Informacione te pergjitheshme**

Subjekti Person Fizik "AGRON HOXHA" është krijuar Ne Qendren Kombetare te Regjistrimit Tirane, date 15/05/2012.

Forma ligjore e subjektit është PERSON FIZIK, subjekt i tatim fitimit dhe tvsh-s. Veprimtaria kryesore tregtare e tij është: PUNIME TE NDRYSHME NE FUSHEN E MOBILERISE.

Selia e Subjektit dhe Adresa e ushtrimit te aktivitetit është Rr.Myslym Keta, Lagjja Tufinë Dajt, Tirane.

### **Permbledhje e politikave kontabel**

#### **Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare janë pergatitur në përputhje me ligjin shqiptar "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato janë pergatitur mbi bazen e parimit te koston historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit te drejtave te kostatuara. Ato paraqiten ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar ("lekë).

Ne paraqitjen e pasqyrave financiare është zbatuar formati i SKK-2 i permirsuar.

Parimet kontabile më domethënëse që janë pëdorur, janë si më poshtë:

#### **Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve**

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri te mjaftushme ne marrjen e perfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe te ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlllogariten me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atehere kur ato sigurohen prej te treteve dhe ne te njejtin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura.

#### **Monedhat e huaja**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e koston historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga Banka e Shqiperise për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2020 janë 1 euro=123.7 leke dhe 1 dollar= 100.84 leke.



### Tatimin mbi fitimin

Shpenzimi per tatimin mbi fitimin perfaqeson shumen e tatimit per tu paguar per vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem per vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregetar qe raportohet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin per ushtrimin 2020 eshte 15 %.

### Kërkesat për t'u arkëtuar

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në para regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

### Pasivet financiare

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parë, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

### Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara

Aktivet afatgjata materiale (AAM-të) bazohen ne modelin e koston. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi është llogaritur mbi bazen e metodes lineare per ndertesat dhe mbi bazen e vleres se mbetur per pjesen tjetere te aktiveve te qendrueshme. Normat e perdorura jane ne ndertesat 5 % te vleres fillestare dhe per aktivet e tjera 20% te vleres se mbetur.

### Gjendjet e inventaret

Vlerësimi ne hyrje i inventareve behet me cmimet e blerjes dhe ne rastet kur eshte e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara per te sjelle inventaret ne kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit ne pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve te fundit te ushtrimit qe nga drejtimi eshte çmuar si vlera neto te realizueshme.

### Aktive monetare (likuiditete në arke dhe bankë)

Gjendjet e mjetet monetare ne banke dhe arke, ne leke dhe valute, ne date 31 Dhjetor 2020 jane si me poshte:

| Emertimi        | Viti Raportues<br>31.12.2020 | Viti Paraardhes<br>31.12.2019 |
|-----------------|------------------------------|-------------------------------|
| Aktive monetare | 1,387,009                    | 4,517,191                     |

AGRON HOXHA  
Punime te Ndrreshme S.R.L.  
Cel. 0692002310, Tirane - Albania

Gjendjet e llogarive te likuiditeteve te paraqitura ne pasqyrat financiare jane te njejta me te dhenat e kontabilitetit rrjedhes dhe konfirmohen me inventaret fizike te monedhave. Tepricat e shprehura ne monedhe te huaj, jane perkthyer ne leke duke perdorur kursin e kembimit te fundit te ushtrimit te bankes se Shqiperise.

#### INVESTIME

Subjekti nuk ka investime ne tituj pronesishte te njesive ekonomike brenda grupit, ne aksionet e veta dhe te tjera financiare.

#### TE DREJTA TE ARKETUESHME

Kerkesat e arketueshme dhe aktive te tjera financiare, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2020 deklarohen si vijon:

| E m e r t i m i          |  | Viti Raportuse<br>31.12.2020 | Viti Paraardhes<br>31.12.2019 |
|--------------------------|--|------------------------------|-------------------------------|
| Të drejta të arkëtueshme |  | <b>18,781,799</b>            | <b>6,597,973</b>              |
| 1                        | Nga aktiviteti i shfrytëzimit              | 8,875,907                    | 6,380,235                     |
| 2                        | Nga njësitë ekonomike brenda grupit        | 0                            | 0                             |
| 3                        | Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesë | 0                            | 0                             |
| 4                        | Të tjera                                   | 9,905,892                    | 217,738                       |
| 5                        | Kapital i nënshkruar i papaguar            | 0                            | 0                             |

Ne -Te drejta te arketueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit jane pasqyruar kerkesat ndaj klienteve per shitjen e mallrave dhe shërbimeve.

Keta kliente jane ELBASAN DUE SHPK, BARDHI SHPK, ANILA HALLUNAJ, ERVIN GOLEMI, BEHAR HOXHA, MAKRI KONSTANTINA, KRISTO SALAVANTIS, N.T.SH TULIPAN, TAULANT YZEIRI dhe APOSTOLOPOYLOS DIONISIOS, shitja e produkteve (mallrave) te cileve eshte bere dhe arketimet priten te behen brenda nje kohe shume te shkurter kohe dhe nuk parashikohen rnie ne vlere. Vlerat analitike per secilin klient jane ne anekset e pasqyrave financiare te vitit 2020.

Ne postin-Te tjera, eshte pasqyruar teprica kreditore e tvsh-s prane doganes, ne vlere 45141 leke, teprica kreditore e tvsh-s ne tatime ne vlere 323,984 leke dhe shumat e terhequra nga personi fizik.

#### Inventari

Gjendja e inventarit ne fund te ushtrimit paraqitet si vijon.

Vlersimi i stokut eshte bere sipas standartit.(skk nr 4)

| E m e r t i m i |  | Viti Raportuse<br>31.12.2020 | Viti Paraardhes<br>31.12.2019 |
|-----------------|--|------------------------------|-------------------------------|
| Inventarët      |  | <b>0</b>                     | <b>0</b>                      |
| 1               | Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme           | 0                            | 0                             |
| 2               | Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte                | 0                            | 0                             |
| 3               | Produkte të gatshme                                  | 0                            | 0                             |
| 4               | Mallra   | 0                            | 0                             |
| 5               | Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri) | 0                            | 0                             |
| 6               | AAGJM të mbajtura për shitje                         | 0                            | 0                             |

AGRON HOXHA  
Punimtar i kryesisht M.D.F.  
Cel. 069 892277  
Tirane - Albania

Ne inventaret e lëndës së parë dhe materiale të konsumueshme është pasqyruar gjendja lëndës së parë dhe mallrave për rishitje në fund të periudhës kontabel, i cili në periudhën raportuese është zero.

Jane bërë inventaret fizik dhe gjengja e tyre është e njëjte me vlerën në kontabilitet.

#### Shpenzime të shtyra

Subjekti nuk ka shpenzime të shtyra.

#### Te Arketueshme nga te ardhura te konstatuara

Subjekti nuk ka te arketueshme nga te ardhurat e konstatuara.

#### Aktive financiare afatgjata

Subjekti nuk ka aktive financiare afatgjata.

#### Aktivitet Afatgjata Materiale(AAM-te)

| E m e r t i m i |   | Viti raportues<br>31.12.2020 | Viti paraardhës<br>31.12.2019 |
|-----------------|---|------------------------------|-------------------------------|
|                 | Aktivitet material                            | <b>1,157,936</b>             | <b>1,447,733</b>              |
| 1               | Toka dhe ndërtesa                             | 0                            | 0                             |
| 2               | Impiante dhe makineri                         | 1,102,817                    | 1,403,744                     |
| 3               | Të tjera Instalime dhe pajisje                | 55,119                       | 43,989                        |
| 4               | Parapagime për aktive materiale dhe në proces | 0                            | 0                             |

#### Aktive biologjike afat gjata

Subjekti nuk ka aktive biologjike.

#### Aktive Afat gjata jo materiale

Subjekti nuk ka aktive afat gjata jo materiale.

Detyrimet që subjekti ka, janë pasqyruar si më poshtë;

AGRON HOKHA  
Punimtar Ndryshues M.D.F.  
Cel. 0692052319 Tirane - Albania

| <b>PASIVET</b>         |   | <b>Viti<br/>Raportues<br/>31.12.2020</b> | <b>Viti<br/>Paraardhes<br/>31.12.2019</b> |
|------------------------|---|--|---|
| Detyrime afatshkurtra: |   | 13,743,097                               | 9,537,885                                 |
| 1                      | Titujt e huamarrjes   | 0  | 0   |
| 2                      | Detyrime ndaj institucioneve të kredisë                           |  |   |
| 3                      | Arkëtime në avancë për porosi                                     |  |   |
| 4                      | Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit                       | 4,380,455                                | 2,431,276                                 |
| 5                      | Dëftesa të pagueshme  |  |   |
| 6                      | Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike brenda grupit                |  |   |
| 7                      | Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse  | 0  |   |
| 8                      | Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore | 8,880,091                                | 6,772,686                                 |
| 9                      | Të pagueshme për detyrimet tatimore                               | 378,906                                  | 333,923                                   |

Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit jane pasqyruar detyrimet ndaj furnitoreve qe lidhen me blerjet e realizuara gjate vit ushtrimor si dhe detyrime te viteve paraardhese. Jane dhene ne menyre analitike ne anekset e pasqyrave financiare.

Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore jane detyrimet qe lidhen me pagat e papaguara dhe detyrimet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore te muajit dhjetor 2020.

Të pagueshme për detyrimet tatimore pasqyrojne detyrimet per tatimin ne burim 17,469 leke per qerane e magazines, dhe tatimin mbi fitimin e vitit 2020 ne vlere 361,437 leke, ne total 378,906 leke.

Drejtimi mendon se te gjitha detyrimet afat shkurtra do te paguhen ne nje periudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie ne vlere.

#### **Te pagueshme per shpenzime te konstatuara**

Subjekti nuk ka detyrime te pagueshme per shpenzime te konstatuara.

#### **Te ardhura te shtyra**

Subjekti nuk ka te ardhura te shtyra.

#### **Provizione**

Subjekti nuk ka provizione.

#### **Detyrime afat gjata**

Subjekti nuk ka detyrime afat gjata.


#### **Te pagueshme per shpenzime te konstatuara**

Subjekti nuk ka te pagueshme per shpenzime te konstatuara.

#### **Te ardhura te shtyra**

Subjekti nuk ka te ardhura te shtyra.

#### **Provizione**



Subjekti nuk ka provizione.

#### Detyrime Tatimore te shtyra

Subjekti nuk ka detyrime tatimore te shtyra.

#### KAPITALET

##### Kapitalet e veta:

Kapitalet e veta te subjektit jane si vijon:

| KAPITALI                    | Viti Raportues<br>31.12.2020 | Viti Paraardhes<br>31.12.2019 |
|-----------------------------|------------------------------|-------------------------------|
| Kapitali dhe Rezervat       |                              |                               |
| Kapitali i Nënshkuar        | 0                            | 0                             |
| Primi i lidhur me kapitalin | 0                            | 0                             |
| Rezerva rivlerësimi         | 0                            | 0                             |
| Rezerva të tjera            | 0                            | 0                             |
| 1 Rezerva ligjore           | 0                            | 0                             |
| 2 Rezerva statutore         | 0                            | 0                             |
| 3 Rezerva të tjera          | 0                            | 0                             |
| Fitimi i pashpërndarë       | 3,025,012                    | 0                             |
| Fitim / Humbja e Vitit      | 4,662,280                    | 3,025,012                     |
| <b>Totali i Kapitalit</b>   | <b>7,687,292</b>             | <b>3,025,012</b>              |

Gjate ushtrimit kontabel 2020 ka rritje te postit Kapitali, te barabarte me fitimin e realizuar gjate vitit 2020. Statusi juridik i subjektit eshte person fizik, dhe fitimet e realizuara perdoren per perdorim vetjak.

Gjate ushtrimit kontabel 2020 eshte realizuar nje fitim neto prej 5,249,606 leke.

| <b>Pasqyra e Performancës<br/>(Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve)</b> |                              |                                  |
|--|------------------------------|----------------------------------|
| Formati 1 – Shpenzimet e shfrytëzimit të klasifikuara sipas natyrës        | Viti Raportues<br>31.12.2020 | Viti<br>Paraardhes<br>31.12.2019 |
| Pershkrimi i Elementeve  |                              |                                  |
| Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit                                   | 42,852,323                   | 32,975,136                       |
| Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces    | 0                            | 0                                |
| <b>Totali te ardhurave</b>   | <b>42,852,323</b>            | <b>32,975,136</b>                |

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit jane nga shitja e produkteve. Jane vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, te zhveshura nga TVSH-ja. Njohja dhe vleresimi jane bazuar ne SNK-9. Paraqitja ne pasqyrat financiare eshte bere sipas natyres se tyre. Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe punës në proces, eshte gjendja e inventarit ne fund te periudhes



kontabel ku pakësimet e pozicioneve njihen si shpenzime dhe rritjet e pozicioneve si pakësim i shpenzimeve (shpenzime negative).

#### Te ardhura gjithperfshirse

Subjekti nuk ka te ardhura gjithperfshirse.

#### Shpenzimet e veprimtarise kryesore.

Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve e sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane rregjistruar me shumate e paguara ose te pagueshme.

| Pershkrimi i Elementeve   | Viti Raportues<br>31.12.2020 | Viti Paraardhes<br>31.12.2019 |
|---|------------------------------|-------------------------------|
| Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme                              | <b>(32,096,840)</b>          | <b>(24,414,709)</b>           |
| Lënda e parë dhe materiale të   |                              |                               |
| 1 konsumueshme  | (28,070,010)                 | (22,774,119)                  |
| 2 Të tjera shpenzime  | (4,026,830)                  | (1,640,590)                   |
| Shpenzime të personelit   | <b>(5,030,470)</b>           | <b>(4,678,154)</b>            |
| 1 Paga dhe shpërblime   | (4,310,600)                  | (4,008,700)                   |
| Shpenzime të sigurimeve   |                              |                               |
| 2 shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet) | (719,870)                    | (669,454)                     |
| Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale                              | -                            |                               |
| Shpenzime konsumi dhe amortizimi  | <b>(314,196)</b>             | <b>(327,024)</b>              |
| Shpenzime të tjera shfrytëzimi  |                              |                               |
| <b>Totali shpenzimeve</b>   | <b>(37,441,506)</b>          | <b>(29,419,887)</b>           |

Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane rregjistruar me shumate e paguara ose te pagueshme dhe jane pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar. Taksat lokale e shpenzime te tjera si transporti, qeraja e te tjera qe lidhen me biznesin jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit, ne zerin shpenzime te tjera shfrytezimi.

Shpenzime personeli. Kostot e punesimit jane pasqyruar ne pasqyren e rezultatit financiar sa me siper ne zerin paga dhe shpenzime per sigurime shoqerore e shendetesore.

Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2020 jane treguar ne pasqyren perkatese.

#### Te ardhurat dhe shpenzimet financiare jane pasqyruar si me poshte:

| Pershkrimi i Elementeve  | 2020          | 2019         |
|--|---------------|--------------|
| Shpenzime financiare   | <b>74,259</b> | <b>3,589</b> |
| Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas   |               |              |
| 1 shpenzimet për t'u paguar tek njësitë ekonomike brenda grupit) |               | (27,366)     |
| 2 Shpenzime të tjera financiare                                  | 74,259        | 30,955       |

AGRON HODJA  
Kryetar i Bordit të Menaxhimit  
Rr. "Dëshmorët e Kombit" M.2.E  
Tirane - Albania

Numri mesatar i punonjesve dhe pagat sipas kategorite kryesore jane si me poshte :

| Kategorite                                    | Ushtrimi 2020 (000 leke) |       |                     | Ushtrimi 2019 (000 leke) |       |                     |
|---|--------------------------|-------|---------------------|--------------------------|-------|---------------------|
|   | Numer mesatar            | Paga  | Sgurime punedhenesi | Numer mesatar            | Paga  | Sgurime punedhenesi |
| I Vetpunesor, Persona te papaguar te familjes |                          |       |                     |                          |       |                     |
| Specialist me arsim universitar               |                          |       |                     |                          |       |                     |
| Teknike                                       |                          |       |                     |                          |       |                     |
| Punetor                                       | 14                       | 4,311 | 720                 | 13                       | 4,008 | 669                 |
| Shuma   | 14                       | 4,311 | 720                 | 13                       | 4,008 | 669                 |

#### Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimi mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2020 jane si vijon:

| PERCAKTIMI I REZULTATIT TATIMOR               | Viti 2020        | Viti 2019        |
|---|------------------|------------------|
| Fitimi/Humbja para tatimit                    | 5,485,076        | 3,558,838        |
| Shpenzime te pa njohura per efekt fiskal      | 0                | 0                |
| Amortizimi tej normave fiskale                | 0                | 0                |
| shpenzime sporizimi tej kufirit lejuar        | 0                | 0                |
| Gjoha,penalite demshperblime                  | 228              | 0                |
| Provizione e shpenzime te tjera te pa njohura | 0                | 0                |
| Shpenzime pa ft.tatimore                      | 0                | 0                |
| Te tjera(interesa bankare mbi 1:4)            | 0                | 0                |
| Pjese nga Humbja e mbartur                    | 0                | 0                |
| Fitimi/Humbja para llogaritjes tatimit        | 5,485,304        | 3,558,838        |
| 1 Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin      | 822,796          | 533,826          |
| 2 Shpenzimi i tatim fitimit të shtyrë         | 0                | 0                |
| Fitimi/Humbja e vitit                         | <b>4,662,280</b> | <b>3,025,012</b> |

Rezultati i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatushem, i cili rregullohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal, analizuar ne tabelen e mesiperme. Per vitin ushtrimor, subjekti ka shpenzime te panjohura ne vlere 228 leke.

#### Transaksione te paleve te lidhura

Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksioni dhe marredhenie te mundeshme, jane kryer ne perputhje me formen ligjore te tyre, ne 31 dhjetor 2020.

#### Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Asnje ngjarje e rendesishme nuk ka ndodhur pas dates se hartimit dhe miratimit te pasqyrave financiare.





**Vijueshmeria e aktivitetit;**

Mendoj qe vijueshmeria e biznesit eshte e garantuar edhe per vitin ne vazhdim ;

- ✓ Ka emer te mire per sherbimet cilesore qe afron.
- ✓ Ka kerkesa per te arketuar per te perballuar disa detyrime .
- ✓ Per momentin nuk ka asnje konflikt gjygsor me kreditoret.
- ✓ Eshte korekt ne mardhenie me shtetin.
- ✓ Ka realizuar nje norme pozitive dhe te mire rentabiliteti.

Tirane me, 02/03/2021

**Hartoi pasqyrat financiare dhe shenimet perkatese :**

*KM Lionika Allmuga*

